



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA “ALBPETROL” SHA
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. _____ Prot.

Patos më, ____ .11.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Punë

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: "Rehabilitim i Grupit 490 Zharrez, QPN Fier, Qendres 59 Drenove, Sektori Cakran Mollaj dhe Grupit 6, Sek II , QPN Gorisht"

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45000000-7 - Punë ndërtimi

VLERA E FONDIT LIMIT: 272,539,738.43 (dyqind e shtatëdhjetë e dy milion e pesëqind e tridhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e tridhjetë e tetë pikë dyzet e tre) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndyshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndyshuar, autoriteti/enti kontraktor Albpetrol sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kërkesat e mësipërme janë detyruese dhe i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për të krijuar bindjen e tij se operatorët ekonomikë pjesëmarrës ushtrojnë veprimtarinë e tyre konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, përmbushin kriteret ligjore për të marrë pjesë në procedura prokurimi, si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet, sipas përcaktimeve të legjislacionit përkatës.

Po ashtu, paraqitja e sigurimit të ofertës është detyrim ligjor i përcaktuar nga legjislacioni në fuqi mësipërcituar, si një mjet garancie për AK në rast të tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave; refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit apo mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimit të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): 2.1.1.

Kapaciteti ligjor plotësohet duke dorëzuar dokumentat sipas Kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, të ndryshuar, nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin, Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në Nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe në Nenin 43, pika 2 gërma "b" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". ku përcaktohet se: *"Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar"*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedurës është "E Hapur – Punë Publike - ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar – Prokurim publik me mjete elektronike", përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të Nenit 43, pika 2, gërma "b" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ku përcaktohet se: *"Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar"*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Nenin 43, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" ku përcaktohet se: *"Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare"*.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023, 2024 të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, **ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe Nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në Nenin 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore" citohet se *"Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit"*

pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është kërkuar duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: *“Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej **50 milionë lekësh;** ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej **100 milionë lekësh;** iii) ka, mesatarisht, **30 të punësuar** gjatë periudhës kontabël”.*

Kriteret e mëposhtme teknike nga pika 2.3.1 dhe në fund janë propozuar dhe vendosur nga specialisti i fushës inxhinier, pjesë e njësisë së prokurimit, sipas përcaktimit të nenit 74, dhe 78 të VKM nr. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik si dhe njoftimit nr. 4916/2 prot, datë 14.07.2022, pika 1, të Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi organizmin e Procedurave të Prokurimit Publik”.

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatorët ekonomikë duhet të kenë përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme dhe për këtë duhet të paraqesin :

- a)** dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- b)** dokumentacion për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e ulët se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;

- Aktin e kolaudimit;

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve, (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Fatura tatimore përkatëse, të deklaruara në organet tatimore

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, ofertuesi, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, ofertuesi duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose minimalisht sa dyfishi i fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar me sukses kontratën objekt prokurimi, sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Në mbështetje të Nenit 88, pika 3 e VKM 285/2021, parashikon se: *“Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht”.*

Në mbështetje të Nenit 88, pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve”.*

Pra në rastet e BOE, dokumentacioni i kërkuar për të vërtetuar përvojën e mëparshme si kontrata e bashkëpunimit, disponohet nga çdo OE në rastin kur ka qenë palë në Bashkimin e OE. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që ka çdo shoqëri në dosjen e saj në rastin kur ka qenë në atë status, e për rrjedhojë nuk është në kundërshtim me

asnjë nga dispozitat ligjore të prokurimit publik dhe nuk sjell asnjë kufizim të pjesëmarrjes së OE në procedurën e prokurimit në fjalë.

2.3.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*. të ndryshuar, në përputhje me zërat e punimeve që përfshihen në preventivin e punimeve, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

NP-1 A Punime germimi ne toke

NP-2 B Ndërtime civile dhe industriale

NP-3 B Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile e industrial, veshje fasada

NP-7 C Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje

Për punimet special të ndërtimit:

NS-1 A Punime per prishjen e ndertimeve

NS-8 B Ndertime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri

NS-14 B Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj

NS-18 A Punime topogjeodezike

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 *“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*, i ndryshuar si dhe Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*. Gjithashtu, të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, Ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”* të ndryshuar, ku Neni 8 përcakton se: *“Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane”*.

NP-1 A Punime germimi në tokë.

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008, punime germimi në tokë konsiderohen germimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të germohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me zbatimin e punimeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure. Dokumentacioni teknik i hartuar nga projektuesi parashikon punime germimi, sistemimi të dherave dhe ndryshime të volumit të tokës. Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve në

preventivin e projektit të zbatimit. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

N.P - 2 B Ndërtime civile e industriale.

Me punime të tilla, referuar VKM nr.42 të datës 16.01.2008 konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të paranderur, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me tipologjinë e ndërtimit që parashikohen për realizimin e këtij projekti. Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve në preventivin e projektit të zbatimit. Kategoria B i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

NP-3 B Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile e industrial, veshje fasada

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008, N.P. 3 Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash, Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me tipologjinë e ndërtimit që parashikohen për realizimin e këtij projekti. Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve në preventivin e projektit të zbatimit. Kategoria B i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

N.P - 7 C Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje.

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar, punime të tilla konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin "e shërbimit hidrik kompleks" dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta, si edhe në të gjitha impiantet mekanike të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me tipologjinë e ndërtimit që parashikohen për realizimin e këtij projekti. Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve në preventivin e projektit të zbatimit. Kategoria C i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

NS-1 A Punime për prishjen e ndertimeve

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar, punime të tilla konsiderohen çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarme dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me tipologjinë e ndërtimit që parashikohen për realizimin e këtij projekti. Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve në preventivin e projektit të zbatimit. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

N.S-8 B Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar, punime të tilla *Përfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrikate prej betoni të armuar, normal dhe të paranderur. Prodhimin në kantier dhe montimin në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose materiali tjetër. Prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vend të strukturave të përbëra nga elementë të drejtë të trajtuar përpara.*

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me tipologjinë e ndërtimit që parashikohen për realizimin e këtij projekti. Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve në preventivin e projektit të zbatimit. Kategoria B i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

NS-14 B Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar, punime të tilla *Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.*

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me tipologjinë e ndërtimit që parashikohen për realizimin e këtij projekti. Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve në preventivin e projektit të zbatimit. Kategoria B i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

N.S - 18 A Punime topogjeodezike.

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar, punime të tilla *Konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.*

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me tipologjinë e ndërtimit që parashikohen për realizimin e këtij projekti. Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve në preventivin e projektit të zbatimit. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

2.3.3. Stafi kryesor e mbështetës, punonjesit, licencimet, çertifikimet.

Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë minimalisht inxhinierët e mëposhtëm:

- Inxhinier Ndertimi 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Mekanik 1 (një)
- Inxhinier Topograf/Gjeodet 1 (një)

Inxhinieret e sipercituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në liçensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesën e shoqërisë minimalisht për tre muajt e fundit.

Për secilin inxhinier drejtues teknik duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Diploma e arsimit të lartë/licenca.
- Listëpagesat e shoqërisë për të paktën tre muajt e fundit në të cilat inxhinieret e sipërpermendur duhet të figurojnë.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e inxhinierëve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këto kritere i ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6. *Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, specifikimet teknike dhe zërat e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, kërkohet që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.*

Në rastin konkret synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë staf të kualifikuar teknik për kryerjen e punimeve objekt kontrate.

Në nenin 8 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” parashikohet se “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.” Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane. Me materiale dhe produkte ndërtimi kuptohet çdo produkt i prodhuar për t’u përfshirë në mënyrë të përhershme në punimet e ndërtimit.”

Sa më sipër, në interpretim të dispozitave të mësipërme, zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga personat të pajisur me licencë të cilët njëherazi mbajnë përgjegjësi për realizimin e punimeve në përputhje me kushtet e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor. Lidhur me disponueshmërinë e Inxhinierëve të mësipërm, njësia e prokurimit gjykon se për sa kohë që autoriteti kontraktor në preventivin e punimeve ka parashikuar punime të një natyre në të cilën shfaqet e nevojshme, parë kjo në raport edhe me pikat dhe kategoritë përkatëse të licencës së kërkuara, dhe referuar volumeve të punimeve të parashikuara në preventivin dhe në projektin përkatës, kriteri i mësipërm është në përputhje dhe proporcion me volumin e kontratës, si dhe në raport me kohëzgjatjen e zbatimit të punimeve të parashikuar, vlerën dhe natyrën e saj,

është një kërkesë në përpjestim me natyrën dhe objektin e punimeve dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme.

Kriteri për stafin teknik kryesor, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, specifikimet teknike dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët, është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Stafi i inxhinierëve, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.4. Operatorët ekonomikë duhet të përcaktojnë me anë të një deklarate nga (Administratori i shoqërisë), Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe që do të sigurojë drejtimin teknik të punimeve në kantier dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, vendosja e këtij kriteri mbështetet në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 4.1, ku përcaktohet se: “drejtimi i kantierit sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga sipërmarrësi ose nga drejtuesit e kantierit (drejtori i punimeve/përgjegjësi teknik i kantierit), që emërohen prej tij. Në rastet kur drejtuesi ligjor e teknik i sipërmarrësit nuk udhëheq drejtpërdrejt punimet në kantier njoftohet, zyrtarisht, investitori për drejtuesit e punimeve dhe personat e tjerë, të emëruar me detyrë në kantier”.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, minimalisht si më poshtë:

- 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë".
- 1 (një) punonjës i trajnuar për inspektimin me termografi (kamera termike).
- 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë të lejes profesionale si drejtues teknik për aktivitetin e përpunimit, transportimit, depozitimit dhe tregëtimit të lëndëve hidrokarbure të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

- 2 (dy) punonjës specialistë të çertifikuar për punime speciale të saldimit sipas standartit EN ISO 9606-1:2017.
- 4 (katër) punonjës të trajnuar për Punimet në lartësi.
- 1 (një) punonjës që disponon kualifikim: “ExF” për njohuritë për ndërgjegjësimin e zonave me rrezikshmëri”.
- 1 (një) punonjës të trajnuar për Sistemet e Monitorimit të Depozitave.
- 4 (katër) punonjës të trajnuar për punimet në ambiente me prani të gazit H₂S.

Për secilin specialist duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Çertifikata/licenca përkatëse.
- Listëpagesat e shoqërise për të paktën muajin e fundit në të cilat specialistët e sipërpërmendur duhet të figurojnë.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e specialistëve me certifikatat përkatëse në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

- 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë".

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" Neni 7 Sherbimet e mbrojtjes dhe te parandalimit ... 1. Punedhenesi ngarkon një ose disa punemarres që të merren me ceshtjet e mbrojtjes, të sigurse e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje /institucion, dhe V.K.M nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier".

- 1 (një) punonjës i trajnuar për inspektimin me termografi (kamera termike).

Sipas kërkesave të objektit të prokurimit, nevojitet instalimi i impianteve që zhvillojnë temperaturë. Në këto kushte, për shkak të rregullave të shëndetit dhe sigurisë në punë, për vlerësimin e punës së këtyre impianteve nëse kanë arritur temperaturën, është e nevojshme inspektimi me kamera termike e këtyre instalimeve.

- 1 (një) punonjës të pajisur me certifikate të lejes profesionale si drejtues teknik për aktivitetin e perpunimit, transportimit, depozitimit dhe tregetimit të lëndëve hidrokarbure të leshuar nga Ministria e Infrastruktura dhe Energjise.

Kjo kërkesë është në përputhje me tipologjinë e objektit të prokurimit. Objekti i punës ka të bëjë me depozitimin, transportin dhe trajtimin e lëndëve hidrokarbure, për këtë arsye duhet një specialist me njohuri mbi këto procese pune.

- 2 (dy) punonjës specialistë të çertifikuar për punime speciale të saldimit sipas standartit EN ISO 9606-1 :2017.

Në ndërtimin dhe montimin e rezervuarve metalikë janë parashikuar se këto punime do të kryhen me saldime dhe për të garantuar kryerjen në kohë dhe me cilësi të saldimeve është kërkuar që operatori ekonomik ofertues të disponojë në stafin e vet minimalisht 2 punonjës për punime speciale të saldimit sipas standartit EN ISO 9606-1 :2017.

- 4 (katër) punonjës të trajnuar për Punimet në lartësi.

Kjo kërkesë është ne perputhje me tipologjinë e objektit të prokurimit pasi parashikohen punime në lartësi të depozitave dhe si rezultat i kësaj rënia nga një lartësi të individëve apo materialeve përbën rrezik të madh për jetën dhe shëndetin e personave të pranishëm në objekt.

- 1 (një) punonjës që disponon kualifikim: “ExF” për njohuritë për ndërgjegjësimin e zonave me rrezikshmëri”.

Kjo kërkesë është ne perputhje me tipologjinë e objektit të prokurimit. Punonjësi i cili posedon këtë certifikatë është i trajnuar posacërisht mbi ndërgjegjësimin dhe menaxhimin e rrezikut në zona specifike.

- 1 (një) punonjës të trajnuar për Sistemet e Monitorimit të Depozitave.

Kjo kërkesë është ne perputhje me tipologjinë e objektit të prokurimit. Punonjësi duhet të ketë njohuri rreth sistemeve operative mbi të cilat do të instalohen softet përkatëse.

- 4 (kater) punonjës të trajnuar për punimet në ambiente me prani të gazit H_2S .

Kjo kërkesë është ne perputhje me tipologjinë e objektit të prokurimit. Punonjësi i cili posedon këtë certifikatë është i trajnuar posacërisht mbi ndërgjegjësimin dhe menaxhimin e rrezikut në zona specifike ku ka prani të gazit H_2S .

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës minimumi:

- Teknik Ndërtimi 1 (një)
- Gjeodet/topograf 1 (një)
- Hidroizolues 1 (një)
- Hidraulik 2 (dy)
- Bojaxhi 1 (një)
- Elektracistë 3 (tre)
- Drejtues mjeti (shoferë) 2 (dy)
- Drejtues eskavatori 1 (një)
- Drejtues të makinerive të rënda 2 (dy)
- Manovrator/Automakinist 1 (një)
- Saldator i thjeshtë 1 (një)
- Saldator me dëshmi saldimit me TIG 1 (një)
- Montator 1 (një)
- Hekurkthyes 1 (një)
- Karpentier 3 (tre)

të vertetuar me diploma/certifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente, kontratë pune të vlefshme, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për muajin e fundit.

Për drejtuesit e mjeteve (shoferët), kur mjetet disponohen me qira drejtuesit e mjeteve (shoferët) mund të disponohen së bashku me mjetet e mara me qira, pa pasur nevojë të jenë të përfshirë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues.

Për secilin specialist duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale pune të vlefshme.
- Diploma/certifikata përkatëse, që vërteton nivelin e kualifikimit profesional, lëshuar nga institucione publike/private, të licencuara/akredituara, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit në të cilat specialistët e sipërpërmendur duhet të figurojnë.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e stafit teknik në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

Argumentim. Në kriterin mësipërm është kërkuar që OE të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, sipas fushave që përfshijnë punimet për zbatimin e projektit. Përcaktimi i numrit të punonjësve dhe profesionet janë bazuar mbi zërat dhe volumet e punës si dhe afateve për përfundimin e punimeve, në mbështetje të Manualit të ndërtimit miratuar me VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre. Bazuar në katër elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore. Këtu përfshihen kërkesat për punonjësit, të cilët janë trajnuar/certifikuar për kryerjen e punimeve të caktuara të zbatimit, pasi kanë kryer me sukses kurse dhe trajnime profesionale për punimet respektive. Zbatimi i punimeve që përfshin projekti duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Nisur nga punimet e parashikuara të zbatimit, në kriteret e veçanta janë kërkuar punëtorët e kualifikuar.

2.3.7. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 60 (gjashtëdhjetë) persona minimumi për muajin e fundit.

Për kete te paraqitet:

- Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për minimalisht muajin e fundit.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e fuqisë punëtore në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

Argumentimi: Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialistët e fushës kanë kryer një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, të deklaruar tregun besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit të parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore është dokument vërtetues, dhe është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 60 persona duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.8. Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamioncine	në pronësi ose me qira	Copë 1
2	Kamion me karrocë (Dumper)	në pronësi ose me qira	Copë 2
3	Kamion min 20 m ³	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Makina pickup	në pronësi ose me qira	Copë 2
5	Eskavator	në pronësi ose me qira	Copë 2
6	Minieskavator	në pronësi ose me qira	Copë 2
7	Fadrome	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Autovinc min.3 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Mates Tokezimi me certifikate kalibrimi	në pronësi ose me qira	Copë 1
10	Gazogjen	në pronësi ose me qira	Copë 1
11	Kalander	në pronësi ose me qira	Copë 1
12	Fresibel per zmusim	në pronësi ose me qira	Copë 1
13	Multimeter Digital me certifikate kalibrimi	në pronësi ose me qira	Copë 1
14	Dare multimeter me certifikate kalibrimi	në pronësi ose me qira	Copë 1
15	Kamera Termike	në pronësi ose me qira	Copë 1
16	Aparate Saldimi TIG 410A me inverter	në pronësi ose me qira	Copë 2
17	Aparate Saldimi MIG/MAG 500A me inverter	në pronësi ose me qira	Copë 1
18	Makineri pastrimi me rere kuarcore	në pronësi ose me qira	Copë 1
19	Vibrator betoni	në pronësi ose me qira	Copë 1
20	Kompresor ajri	në pronësi ose me qira	Copë 1
21	Pajisje topografike GPS Set	në pronësi ose me qira	Copë 2
22	Pajisje topografike Total Station Set	në pronësi ose me qira	Copë 1
23	Kontenier kantieri	në pronësi ose me qira	Copë 1

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: -leja e qarkullimit; -çertifikatën e kontrollit teknik; siguracionin dhe fotot perkatese;
- Ndersa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese, fotot, ndersa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara në procedurë të shpallura fitues.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e mjeteve dhe pajisjeve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

2.3.9. Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

- ISO 9001: 2015 (Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalent.
- ISO 14001: 2015 (Sistemet e Menaxhimit Mjedisor) ose ekuivalent.
- ISO 45001: 2018 (Sistemet e Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë) ose ekuivalent.
- EN 1090-2:2018 (Kërkesa teknike për realizimin e konstruksioneve prej çeliku) ose ekuivalent.

Shënim: Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, secili anëtar i bashkimit duhet të plotësojë kriterin në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësi, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga

organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

EN 1090-2:2018 është standart ndërkombëtar, i cili përcakton kërkesat teknike për realizimin e konstruksioneve prej çeliku.

2.3.10. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar nga prodhuesi për: mates dixhitali me nivel me radar me vale të drejtuara, celes tejmbushje, valvul ajrosje për depozita naftë, valvul ajrosje të emergjencës, kalimatës naftë, PLC, HMI-nderfaqe operimi, tubi i celikut, që janë objekt prokurimi. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet lidhur me prodhuesin dhe distributorin. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të kontaktit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 40, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave dhe pajisjeve të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave dhe pajisjeve të lëshuara direkt nga prodhuesi apo nga distributori i autorizuar i tyre. Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose autorizimit të distributorit të autorizuar për furnizimin e mallrave dhe pajisjeve që do të ofrohen, është kërkesë ligjore e domosdoshme, me qëllim që OE të kenë autorizimin për tregtimin e produkteve nga prodhuesi apo distributori i autorizuar, duke treguar origjinalitetin e tyre dhe ofruar garanci për mallrat që do të furnizohen.

Për nga vetë natyra e veçante e procedurës së prokurimit, me qëllim realizimin e kontratës që prokurohet, kriteri i sipërcituar është një kërkesë e nevojshme që lidhet drejtpërdrejt me rëndësinë dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe që mund të plotësohet nga çdo operator ekonomik, cili ka kapacitetet e nevojshme për realizimin e procedurës.

2.3.11. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog /skedë teknike për pajisjet/mallrat: mates dixhitali me nivel me radar me vale të drejtuara, celes tejmbushje, valvul ajrosje për depozita naftë, valvul ajrosje të emergjencës, PLC, HMI-nderfaqe operimi, kalimatës naftë, tubi i celikut, që janë objekt prokurimi, sipas të cilave plotësohen specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara. Katalogu/skeda teknike të përmbajë karakteristikat teknike të pajisjeve/materialeve me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse këto pajisje/materiale plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Në katalogun/et/skeda të paraqitura të shihen në mënyrë të dukshme modeli i pajisjes/materialit të ofruar, së bashku me specifikimet teknike të kërkuara nga AK. (Pjesët specifike të katalogut/skedës teknike, ku jepen karakteristikat teknike nëqë nuk janë në gjuhën shqipe të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të notëzohen).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 36, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 40, pika 6 gërma b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. OE duhet të paraqesin skeda teknike/katalogë për disa prej artikujve kryesor të objektit të prokurimit, ku të shprehin qartë secilin lloj të mallit që ofertojnë, për të gjykuar nëse mallrat që do të lëvrohen nga operatorët ekonomikë janë në përputhje të plotë me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, se OE do të furnizojë me ato mallra që ka paraqitur në

ofertën e tenderit dhe për të cilën do të jetë shpallur fitues. Kërkesa për skedat teknike/katalogë është vendosur për pajisjet që kanë një rëndësi të vecantë për AK dhe një vlerë të konsiderueshme.

2.3.12. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **deklaratën** ku të shprehet se është dakord me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues). Paraqitja e kësaj deklarate është kërkuar, pasi financimi është parashikuar sipas programit të zhvillimit të shoqërisë edhe pse afati i realizimit është sipas grafikut të punimeve

Argumentimi: Për shkak të financimit të projektit duhet që operatorët ekonomikë të bien dakort me mënyrën e pagesës pavarësisht grafikut të realizimit të punimeve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga inxhinierët e projektuesit të cilët kanë njohuri të posacme për objektin e prokurimit.

Shënim: Në të gjitha rastet në specifikime teknike ose preventiv ku mund të jenë përmendur markë specifike apo emërtim është parashikuar se do të pranohen edhe ekuivalentët e tyre.

Shënim: Specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Njësia e Prokurimit: